



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr.1910/2 prot.

Tiranë më 24.11.2022

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr.8419 Prot., datë 04.11.2022, me anë të cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (më tej, “Për komunikimet elektronike”), në vijim gjeni qëndrimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më tej, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektligjit “Për komunikimet elektronike”, konstatohet se ky projektligj reflekton në tërësi frymën e GDPR dhe zbaton parimet dhe rregullat e legjislativës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Megjithatë, duke marrë parasysh që legjislativi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ai për komunikimet elektronike janë në të njëjtën fazë përafrimi me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, vlerësojmë se hartimi i tyre në harmoni me njëri - tjetrin është i rëndësishëm dhe përbën një zhvillim konkret në procesin e integritit të vendit.

Sikurse jeni në dijeni, Zyra e Komisionerit, me mbështetjen e ekspertëve të projektit të binjakëzimit që asistuan këtë proces, ka përgatitur draftin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafuar me Rregulloren e Përgjithshme të Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) dhe Direktivën e Policisë, i cili pritet të miratohet së shpejti.

Sa më sipër, me qëllim që këto dy projektligje të jenë në të njëjtën linjë, propozojmë të reflektohen disa ndryshime dhe të mbahen në konsideratë disa elementë, si vijon:

Me qëllim unifikimin e terminologjisë me atë të parashikuar në projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sugjerojmë që përkufizimet e parashikuara në pikën 52 dhe 53 të nenit 3 të projektligjit të zëvendësohen me këtë përmbajtje:

“52. Pëlqim i përdoruesit”, nënkupton çdo element tregues të vullnetit të tij, të dhënë lirisht, të informuar dhe të qartë nëpërmjet të cilit përdoruesi, me anë të një deklaratë ose me një veprim të qartë pohues, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale që lidhen me të, për një ose më shumë qëllime specifike”.

“53. Cenim i të dhënave personale”, nënkupton çdo cenim të sigurisë që mund të shkaktojë në mënyrë aksidentale ose të paligjshme shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen ose aksesin e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura, të transmetuara ose të përpunuara në ndonjë mënyrë tjetër.”

Më tej sugjerojmë që pika 4 e nenit 138 “Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale”, të riformulohet duke mbajtur në konsideratë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, të sanksionuara qoftë në nenin 5 të ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, ashtu edhe në nenin 6 të projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sipas përmbajtjes në vijim:

“Të dhënat në këta skedarë përpunohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Sugjerojmë që pika 1 e nenit 139 “Konfidencialiteti”, të riformulohet sipas përmbajtjes në vijim.

“Sipërmarrësit duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të dhënat personale, nga aksesit i paautorizuar ose përhapjen e tyre nga persona të paautorizuar”.

Në germën a), të pikës 2 të nenit 140, sugjerojmë që togfjalëshi “për qëllime ligjore të autorizuara”, të zëvendësohet me togfjalëshin “për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe të ligjshme”.

Nga ana tjetër, në pikat 4 – 9 dhe 12 të kësaj dispozite, parashikohet detyrimi i sipërmarrësve që ofrojnë komunikime elektronike, që në rast cenimi të të dhënave personale, të njoftojnë AKEP për këtë shkelje, dhe sipas rasteve të parashikuara në vijim, edhe pajtimtarin ose individin, duke përfshirë këtu edhe elementët që duhet të përmbajë njoftimi, si dhe detyrimin e sipërmarrësve për të dokumentuar këto shkelje.

Në këtë kuptim, vlerësojmë që të mbahet në konsideratë, se në nenin 34 të projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ashtu sikurse edhe në nenet 33 dhe 34 të GDPR-së, ka një parashikim të posaçëm mbi cenimin e të dhënave personale sipas së cilit, kontrolluesi ka detyrimin që jo më vonë se 72 orë pasi të jetë vendosur në dijeni të cenimit të të dhënave, të njoftojë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe subjektin e të dhënave kur rreziqet e shkaktuara nga cenimi i të dhënave ndaj të drejtave dhe lirive të tyre ka të ngjarë të jenë të larta, dhe kur

kontrolluesi konstaton se masat teknike ose organizative nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme. Në vijim të kësaj dispozite, parashikohen gjithashtu edhe elementët e njoftimit të cilët janë të njëjtë me ato të parashikuar në projektligjin “Për komunikimet elektronike” si dhe detyrimi i kontrolluesit për të dokumentuar çdo cenim të të dhënave.

Sikurse vërehet, detyrimet që i burojnë sipërmarrësve që ofrojnë komunikime elektronike në rast cenimi të të dhënave personale, (të cilët në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale mbajnë cilësinë e kontrolluesve që kryejnë veprimtari në fushën e telekomunikacionit), janë të njëjta me ato të parashikuara në GDPR dhe në projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në këtë këndvështrim, me qëllim shmangien e mbivendosjes së dispozitave, detyrimeve dhe kompetencave institucionale që burojnë prej tyre, sugjerojmë që në projektligjin “Për komunikimet elektronike”, kjo dispozitë të jetë referuese në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

I njëjti argument vlen edhe për pikat 10 - 11, që parashikojnë rregullime mbi kërkesat për auditin e sigurisë dhe të drejtën e AKEP që me vendimmarrjen e tij, të detyrojë sipërmarrësit të zbatojnë masat e nevojshme të sigurisë në rast shkelje, ose kur auditi i sigurisë zbulon masa jo të mjaftueshme të sigurisë. Këto detyrime gjejnë gjithashtu rregullim të posaçëm në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në aktet nënligjore përkatëse, konkretisht në Udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”.

Më tej, sugjerojmë që pika 19 e nenit 140, të riformulohet duke patur parasysh “Parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin”, të parashikuar në nenin 6, pika 1, gërma b) e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sipas të cilit: “Të dhënat personale duhet mblidhen për një qëllim specifik dhe të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar, përveç nëse përpunimi i mëtejshëm parashikohet me ligj të veçantë, për shkak të interesit publik, ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve, duke respektuar thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe në atë masë që është e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e interesit, ose, nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij”.

Sikurse vërehet, ndryshe nga sa prashikon pika 19 e nenit 140 të projektligjit “Për komunikimet elektronike”, përpunimi i mëtejshëm për një qëllim tjetër që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar, lejohet në rast se ky përpunim a) parashikohet me ligj të veçantë, b) për shkak të interesit publik, ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve, duke respektuar thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe në atë masë që është e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e interesit, ose c) nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij. Në këtë kuptim, sugjerojmë riformulimin e kësaj pike në referencë për sa më sipër.

Në pikën 3, të nenit 141, sugjerojmë që termi “pranim paraprak” të zëvendësohet me termin “dhënia e pëlqimit paraprak”.

Duke patur në konsideratë se, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, pëlqimi për përpunimin e të dhënave, duhet të jepet për çdo qëllim specifik në mënyrë të veçuar, me qëllim që subjektit të të dhënave ti jepet mundësia që pëlqimin ta japë ose jo për qëllime të ndryshme nëpërmjet të njëjtit instrument, sugjerojmë që pika 2, e nenit 145, të riformulohet si vijon:

“Personat fizikë ose juridikë, që kanë adresat e postës elektronike nga klientët e produkteve ose shërbimeve të tyre, mund t’i përdorin këto adresa për marketing të drejtpërdrejtë të produkteve apo shërbimeve të ngjashme, vetëm nëse kanë marrë pëlqimin e shprehur qartë se dëshirojnë të kontaktohen për qëllime marketingu nga këto të fundit, si dhe janë të detyruar t’u japin klientëve të tyre mundësinë që, në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, të kenë mundësi të ndalojnë përdorimin, për qëllime marketingu, të postës/adresës së tyre elektronike.”

Në përfundim, bazuar në sa më sipër, sugjerojmë heqjen nga pika 1 (vi) e nenit 157/1 “Gjobat”, të parashikimit për sanksionimin me gjobë të operatorëve, për mospërbushje të detyrimeve për ruajtjen e të dhënave. Kjo për shkak se një kompetencë e tillë, i është veshur një autoriteti tjetër, dhe konkretisht Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, qoftë sipas ligjit të posaçëm qoftë sipas GDPR, që përbën instrumentin ndërkombëtar që rregullon fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi